



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 3, pika 3.5 të kontratës 01-Nr-016-55172 të datës 18.09.2024 të lidhur në mesë Komunës së Suharekës dhe Visar Sokol Basha nga Suhareka dhe konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Raporti me numër të protokollit 01-Nr-052-2910 të datës 14.01.2025 dhe Marrëveshja e hartuar nga komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor, që do të ndërtohet nga **Visar Sokol Basha** në pjesën e parcelës kadastrale **P-72116046-012110-0**, e cila i është dhënë në shfrytëzim me Vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-016-51843, të datës 30.08.2024 dhe sipas kontratës 01-Nr-016-55172 të datës 18.09.2024 për ndërtimin e objektit afarist-banesore.

Neni 2

Pas miratimit të këtij vendim nga Kuvendi i Komunës së Suharekës dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi, obligohet Kryetari i Komunës së Suharekë që të nënshkruan marrëveshjen me Visar Sokol Basha nga Suhareka.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Raporti me numër të protokollit 01-Nr-052-2910 të datës 14.01.2025 dhe Marrëveshja e hartuar nga komisioni i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Suharekës 01-Nr-410-61657 të datës 31.10.2024 për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

01-Nr-_____

Me datë _____